

## SYLLABUS

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Menaxhimi i Hotelerisë</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>III</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3</b>
<b>Vlera në kredi - ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Ass. Dr. Alberta Tahiri</b>
<b>Detajat kontaktuese:</b>	<a href="mailto:alberta.tahiri@ushaf.net">alberta.tahiri@ushaf.net</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	
	Lënda “Menaxhimi i Hotelerisë” paraqet një përmbledhje për sa i përket njohurive lidhur me menaxhimin e hoteleve, përkatësisht ofron një përmbajtje procesit të zhvillimit të hotelerisë si disiplinë në vete. Studentëve iu ofron përgatitje në aspektin teorik dhe profesional. Duke qenë se hoteleria bënë pjesë në sektorin e shërbimeve atëherë jepet rëndësia e këtij sektori në ekonominë e vendit në tërësi.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	
	Kjo lëndë synon që të përgatis dhe aftësojë studentët të cilët në të ardhmen mund të përfshihen në tregun e punës, përkatësisht në sektorin e shërbimeve hoteliere. Rëndësia këtu qëndron në të qëniet të aftë që ata të udhëheqin një hotel ose të jenë pjesë e stafit të hoteleve të ndryshme ku ata të mund t'i shfaqin aftësitë dhe shkathësitë e tyre profesionale. Gjithashtu, synohet të studiohet dhe të krahasohet zhvillimi i hotelerisë në botë dhe në vendin tonë, duke ofruar njohuri mbi sektorin e shërbimeve hoteliere në Kosovë dhe mbi kategorizimin e hoteleve sipas yjeve.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	
	Në përfundim të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të njohin konceptet e menaxhimit të hotelerisë;</li> <li>▪ Të kuptojnë rrjedhën e zhvillimit të sektorit të shërbimeve hoteliere;</li> <li>▪ Të arrijnë njohuri lidhur me organizimin strukturor të hoteleve dhe me rolin e menaxherëve dhe liderëve të hoteleve;</li> <li>▪ Të kuptojnë rëndësinë e departamenteve të ndryshme që funksionojnë brenda hoteleve;</li> <li>▪ Të njohin tregun e shërbimeve hoteliere të vendit tonë;</li> <li>▪ Të kenë qasje në hulumtimet e të ardhmes së sektorit hotelier.</li> </ul>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	4	8
Ushtrime në teren	3	2	6
Kollokfiume, seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	6	3	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet, etj.			
<b>Totali</b>			<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata dhe ushtrime të kombinuara me raste të studimit dhe diskutime në klasë, punime seminarike, diskutime, punë në grupe, etj.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Kolokviumi i parë: 0-30% Kolokviumi i dytë: 0-30% Ushtrimet, seminarët: 0-20% Hulumtimet shkencore: 0-10% Interaktiviteti: 0-10% Provimi përfundimtar: 100%  Provimi final është vlerësuar me 100% të notës. Provimi përbëhet prej pyetjeve me përgjigje të mundshme, pyetjeve të hapura, dhe një rast të studimit.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	Denney G. Rutherford & Michael J. O'Fallon, "Hotel management and operations", Fourth edition, John Willey & Sons, Inc., New Jersey, 2007.		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ A. M. Shellaa, "Economics of hotel management", New Age International (P) Limited, Publishers, New Delhi, 2002.</li> <li>▪ Enda M. Larkin, "How to run a great hotel:</li> </ul>		

	Everything you need to achieve excellence in the hotel industry”, How To Books Ltd, United Kingdom, 2009.
--	---

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Prezentimi i syllabusit dhe hyrje e përgjithshme për lëndën
<b>Java e dytë:</b>	Procesi i zhvillimit të hotelerisë Arti dhe shkenca e hapjes së një hoteli
<b>Java e tretë:</b>	Struktura e organizimit të hoteleve
<b>Java e katërt:</b>	Kornizë konceptuale e punës së menaxherit të përgjithshëm të hotelit Përgatitja e udhëheqësve e ardhshëm të mikpritjes: Modeli i kompetencave
<b>Java e pestë:</b>	Puna elektrizuese e menaxherit të zyrës së përparme (front office) Një ditë në jetën e menaxherit të zyrës së përparme (front office)
<b>Java e gjashtë:</b>	Organizatat e mirëmbajtjes: historia, qëllimi, strukturat dhe personeli i tyre
<b>Java e shtatë:</b>	Kolokviumi I
<b>Java e tetë:</b>	Funksioni i inxhinierisë hoteliere: organizimi, njerëzit dhe çështjet në epokën moderne
<b>Java e nëntë:</b>	Menaxhimi i operacioneve të ushqimit dhe pijeve në organizatat akomoduese
<b>Java e dhjetë:</b>	Aleanca strategjike midis hoteleve dhe restoranteve Organizimi dhe menaxhimi i operacioneve të pijeve hoteliere
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Krijimi i lidershit të tregut: marketingu si proces
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Organizimi dhe operacionalizimi i shitjeve hoteliere
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Shefi ekzekutiv financiar i akomodimit Buxheti dhe parashikimi: praktika aktuale në industrinë e akomodimit
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Nxitja e mikpritjes në të ardhmen Shkaqet dhe pasojat e qarkullimit në industrinë e mikpritjes
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Kolokviumi II

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.